

LIGJ
Nr.9942, datë 26.6.2008

**PËR PARANDALIMIN E ÇRREGULLIMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PAMJAFTUESHMËRIA E JODIT NË ORGANIZMIN E NJERIUT**
(ndryshuar me ligjet: nr. 54/2013, datë 14.2.2013, nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet prodhuese, importuese, eksportuese dhe tregtuese të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime
(ndryshuar terma me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Çrregullime nga pamjaftueshmëria jodike” është një spektër i gjerë çrregullimesh, të dukshme apo të fshehura, të cilat shkaktohen si rezultat i pamjaftueshmërisë së sasisë së jodit në trup, që ndikojnë në zhvillimin intelektual dhe fizik të njeriut. Ato mund të shkaktjnë prapambetje mendore, defekte fizike, strumë etj.
2. “Parandalimi i çrregullimeve me shkak pamjaftueshmërinë jodike” është një sistem masash të marra për përmbushjen e nevojës fiziologjike të organizmit për jod.
3. “Jodizimi i përgjithshëm i kripës” është procesi i pasurimit/shtimit të jodit në kripën për përdorim njerëzor e shtazor dhe në industrinë ushqimore.
4. “Kripë ushqimore e jodizuar” është kripa, së cilës i është shtuar jod, e destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.
5. “Kripë industriale” është kripa, e cila nuk përdoret për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj.
6. “Fortifikimi i kripës me jod” është procesi i shtimit të një sasive jodi në kripë për

plotësimin e nevojave fiziologjike të organizmit të njeriut dhe të kafshëve me jod.

7. “Konsum i drejtpërdrejtë” është marrja e jodit, nëpërmjet kripës me jod, nga njerëzit dhe kafshët.

8. “Konsum i tërthortë” është marrja e jodit nga produktet dhe nënproduktet ushqimore të industrializuara, të cilat janë përpunuar, paraprakisht, me kripë të jodizuar, si dhe nga produktet blegtorale.

KREU II KRITERET PËR CILËSINË DHE SIGURINË

Neni 4

Detyrimi për jodizimin e kripës

Jodizimi i përgjithshëm i kripës për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore është i detyrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Niveli i jodizimit për kripën e prodhuar në vend

Kripa, e prodhuar në vend për konsum të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, nuk lejohet të jodizohet në një nivel më të ulët se 40 mg jod për kg kripë dhe më të lartë se 60 mg jod për kg kripë në pikën e prodhimit.

Neni 6

Niveli i jodizimit për kripën e importuar

Kripa, që importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, në çastin e mbërritjes duhet të jetë e jodizuar në një nivel jo më të ulët se 40 mg jod për kg kripë dhe jo më të lartë se 60 mg jod për kg kripë.

Neni 7

Niveli minimal i jodizimit për kripën që hidhet në treg

Niveli i jodit në kripën, që tregtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, nuk lejohet të jetë më i ulët se 20 mg jod për kg kripë.

Neni 8

Fortifikimi i kripës me jod

1. Niveli i jodit në kripën e jodizuar shprehet vetëm si përmbajtje e jodit në të.

2. Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Pamjaftueshmërisë Jodike është i vetmi organ këshillimor, i cili propozon ndryshimet në sasinë e nivelit të jodit në kripën e jodizuar, sipas neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji, në përputhje me situatën në vend dhe me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe Këshillit Ndërkombëtar për Kontrollin e Çrregullimeve të Pamjaftueshmërisë Jodike (ICCIDD).

Neni 9

Ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar

(shtuar një paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen prodhimi, importimi, tregtimi dhe marketingu i kripës së pajodizuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, duke përjashtuar rastet si më poshtë:

a) importimin e kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjekte të licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin, duke garantuar gjurmueshmërinë;

b) importimin e kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim përdorimin e saj në produktet ushqimore të destinuara për eksport, duke garantuar gjurmueshmërinë;

c) eksportimin e kripës së pajodizuar dhe të ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar, duke garantuar gjurmueshmërinë.

Neni 10

Kriteret për hedhjen në treg të kripës së jodizuar

Asnjë person fizik ose juridik nuk duhet të prodhojë, të importojë, të tregtojë, të shpërndajë, të magazinojë kripë të jodizuar për konsum njerëzor, shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, kur:

a) ka arritur data e skadimit;

b) ka arritur data e skadimit, sipas llojit të fortifikimit:

i) 6 muaj nga data e prodhimit për jodurin;

ii) 12 muaj nga data e prodhimit për jodatin;

c) nuk është në përputhje me treguesit cilësorë, të përcaktuar në këtë ligj dhe me standardet e miratuara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Ambalazhimi dhe etiketimi

1. Ambalazhimi, etiketimi, transportimi dhe ruajtja e kripës së jodizuar bëhen në përputhje me legjislacionin dhe me standardet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Etiketa e përdorur për kripën e jodizuar, krahas të dhënave të përcaktuara në legjislacionin për ushqimin, duhet të përmbajë edhe datën e skadencës, sipas llojit të fortifikimit, në përputhje me shkronjën “b” të nenit 10 të këtij ligji. Emërtimi i produktit të jetë “Kripë e jodizuar”.

3. Në etiketën e kripës së jodizuar mund të vendosen mesazhe promocionale, të cilat nxisin përdorimin e saj nga popullata.

KREU III

KONTROLI DHE MONITORIMI I KRIPËS SË JODIZUAR

Neni 12

Kontrolli i nivelit të jodit në kripë

(ndryshuar me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

1. Kripa e jodizuar, e prodhuar në vend ose e importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, është objekt kontrolli, që përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

a) monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë;

b) inspektimin, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

2. Kontrolli i nivelit të jodit në kripë, në subjektet prodhuese të kripës ushqimore të jodizuar, bëhet për çdo parti malli përpara hedhjes së saj në treg nga struktura rajonale e shëndetësisë. Për kryerjen e analizave të kripës, struktura rajonale përdor laboratorët e brendshëm të saj.

3. Kontrolli i nivelit të jodit në kripën ushqimore të prodhuar në vend ose të importuar, e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, bëhet nëpërmjet analizave laboratorike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas rekomandimeve të OBSH-së, ICCIDD-it dhe UNICEF-it.

4. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga subjektet prodhuese ose importuese të kripës së jodizuar. Tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kripa e jodizuar, që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjektet importuese, i nënshtrohet kontrollit për nivelin e jodit në pikat doganore (degët doganore kufitare). Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor, drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.

6. Për kripën e jodizuar të importit, edhe në rastet kur në dokumentet shoqëruese është pasqyruar niveli i jodit, importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike në laboratorët e strukturës rajonale të shëndetësisë për nivelin e jodit në çastin e futjes së kripës në pikën doganore

Neni 13

Monitorimi i nivelit të jodit në kripë
(ndryshuar me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

1. Monitorimi është procesi sistematik i mbledhjes së mostrave të kripës së jodizuar, analizimit dhe përdorimit të informacionit me qëllim sigurimin e niveleve të jodit në kripën e destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Monitorimi i nivelit të jodit në kripë në pikat e prodhimit në vend apo në ato të importimit dhe në pikat e shitjes me pakicë/shumicë kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë brenda juridiksionit të tyre, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

3. Prodhuesi i kripës së jodizuar në vend dhe importuesi i saj janë përgjegjës për sigurimin e nivelit të jodit në kripë, në përputhje me standardet e këtij ligji.

Neni 13/1

Inspektimi
(shtuar me ligjin nr. 54/2013, datë 14.2.2013)

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Neni 13/2

Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore
(shtuar me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

1. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jodizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj.

2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna:

a) identifikimin e çdo subjekti tregtar/personi juridik apo fizik nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;

b) identifikimin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë të jodizuar;

c) sasinë e kripës së furnizuar dhe nivelin e jodit në momentin e furnizimit;

ç) datën e skadencës së kripës së furnizuar.

3. Operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për jo më pak se 3 vjet dhe siguron që këto të dhëna t'u jepen menjëherë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg, duhet të etiketohet e të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër për të siguruar gjurmueshmërinë.

KREU IV KOMITETI KOMBËTAR PËR ELIMINIMIN E ÇRREGULLIMEVE NGA PAMJAFTUESHMËRIA JODIKE

Neni 14

Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve nga Pamjaftueshmëria Jodike (KKEÇPJ)

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë funksionon Komiteti Kombëtar për Eliminimin e Çrregullimeve nga Pamjaftueshmëria Jodike (KKEÇPJ) si organ këshillimor.

2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i këtij komiteti përcaktohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 15

Kompetencat e KKEÇPJ-së

KKEÇPJ-ja ka këto kompetenca:

a) orienton politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga çrregullimet, që shkaktohen nga pamjaftueshmëria jodike;

b) i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga pamjaftueshmëria jodike;

c) propozon ndryshimet në sasinë e nivelit të jodit në kripën e jodizuar, sipas situatës së pamjaftueshmërisë jodike në vend;

ç) propozon programe dhe projektakte, sipas shkronjës “a” të këtij neni dhe bën monitorimin e vlerësimit të tyre;

d) siguron bashkëpunimin me institucione të ndryshme, të interesuara, brenda dhe jashtë vendit, sipas qëllimit të këtij ligji.

Neni 16

Promovimi i konsumit të kripës së jodizuar

Autoritetet shëndetësore, kombëtare dhe vendore, duhet të promovojnë dhe të

mbështesin, në kuptim të këtij ligji, konsumin e kripës së jodizuar dhe të informojnë popullatën për çrregullimet që shkaktohen nga pamjaftueshmëria jodike.

KREU V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 17

Kundërvajtjet administrative

(shtuar fjalë në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 12/2020, datë 12.2.2020)

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Importimi, prodhimi, shpërndarja, tregtimi apo marketingu i kripës së pajodizuar ose me nivel jodi më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, për konsum njerëzor e shtazor me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

2. Përdorimi i kripës së pajodizuar ose i kripës së jodizuar, me një nivel më të ulët se ai i përcaktuar në këtë ligj, në industrinë ushqimore me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

3. Importimi, shpërndarja, tregtimi apo reklamimi i kripës së jodizuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore pas datës së skadencës, sipas llojit të fortifikimit.

4. Mospërputhja me treguesit e cilësisë, të ambalazhimit, etiketimit, transportit dhe ruajtjes.

Neni 18

Sanksionet

(shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 54/2013, datë 14.2.2013)

1. Kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, dënohen me gjobë si më poshtë:

a) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokim, kthim mbrapsht të mallit, në përputhje me ligjin, sipas rastit, për prodhuesin, tregtuesin apo importuesin e produktit, për shkeljen e parashikuar në pikën 1 të nenit 17 të këtij ligji;

b) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, për shkeljen e parashikuar në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji;

c) 200 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, për shkeljen e parashikuar në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji;

ç) për shkeljet e parashikuara në pikën 4 të nenit 17 të këtij ligji:

i) 500 mijë lekë, shoqëruar me bllokimin e mallit, kur kemi mospërputhje me treguesit cilësorë;

ii) 200 mijë lekë, shoqëruar me bllokim dhe riambalazhim të mallit, në përputhje me ligjin, kur shkeljet lidhen me ambalazhimin, etiketimin, transportin dhe ruajtjen.

1/1 Masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e bllokimit të mallit.

2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

Neni 19

Pezullimi dhe heqja e licencës

1. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkelje të

përsëritur të pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji, u propozon institucioneve përkatëse heqjen e licencës për subjektin përgjegjës.

2. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, për shkelje të përsëritur të pikës 4 të nenit 17 të këtij ligji, u propozon institucioneve përkatëse pezullimin e përkohshëm ose të përhershëm të veprimtarisë së subjektit prodhues.

3. Ndryshimi i destinacionit të mallit, jo në përputhje me standardin për përdorim si kripë industriale, lejohet kundrejt dhënies së lejes përkatëse nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 20

Ankimi dhe ekzekutimi

(ndryshuar me ligjin nr. 54/2013, datë 14.2.2013)

1. Ankimi ndaj vendimit të strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 21

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin rregulloren e përbashkët, në zbatim të pikave 1 e 2 të nenit 11 të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 22

Shfuqizime

Vendimi nr.549, datë 27.11.1997 i Këshillit të Ministrave “Për importimin e kripës së gjellës së jodizuar dhe prodhimin e saj në vend”, shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare

(e vendosur me ligjin nr. 54/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5805, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi